

ÇELJETA NIKOLLA

**Ç'JANË FRAZEOTERMAT, RRUGËT E PASURIMIT  
DHE DALLIMET NGA EMËRTIMET E PATHJESHTA**

Për frazeologjinë studimet kanë qenë të shumta, si nga studiues të huaj ashtu edhe vendas. Studimet rreth saj kanë përfshirë një qerthull bukur të gjerë, të cilat përbëjnë një bazë të rëndësishme për studimet e mëtejshme.

Punimi ynë ka për qëllim dallimin e frazeologjisë nga frazeotermat, që janë një risi për gjuhësinë tonë. Për ta kuptuar edhe më qartë se çfarë janë frazeotermat, jemi bazuar në gjurmët e etërve shqiptarë të frazeologjisë, të studiuesve që i emërtuan dhe hodhën dritë edhe mbi këtë me anë të frazeologjisë.

Në ballë të studimeve prin ndihmesa e *Jani Thomait*, i cili në veprën e tij *“Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe”*<sup>1</sup> thekson se identiteti dhe kufijtë e njësisë frazeologjike e veçojnë atë, në radhë të parë, nga njësi e struktura të afërta a të ngjashme me të. Ai e vijon shpjegimin duke na treguar se në disa togfjalësha, njëra nga fjalët përbërëse ka kuptim të figurshëm e ngushtësisht të kushtëzuar si: sjellje *kalamajsh*, uri *ujku* “shumë i uritur”, fjalë *grash*, gënjeshtër *me bisht*, etj. Zakonisht kjo gjymtyrë ka funksion përcaktori e vlerë mbiemërore dhe kështu togfjalëshat nuk e kanë humbur mëvetësinë e tyre, pra ruajnë mundësitë e lidhjeve, shpjegon ai.

Por nga ana tjetër, tek ky studiues gjejmë edhe konstatime të tilla për njësitë e mësipërme, *terma togfjalëshorë* dhe *emërtime të pathjeshta*, me kuptim të drejtpërdrejtë e të motivueshëm si: qendra e *rëndesës*, pesha *atomike*, truri i *vogël*, poli i *Veriut*, etj., ndërsa togfjalëshat e mëposhtëm i quan me kuptim të figurshëm, të pamotivueshëm drejtpërdrejtë nga kuptimi i gjymtyrëve, si p.sh.: *ballë kazani* “rakia e parë”, *gjurmëmushke* bimë që i ka gjethet në formën e gjurmës së mushkës”. Këto ndërtime ky studiues i dallon nga frazeologjia prerazi edhe pse brenda kuptimit të tyre kanë figurshmëri.

Sipas tij, këto emërtime të pathjeshta kanë pësuar një **rikuptimësim** të plotë të gjymtyrëve që veçohen, kurse kuptimi i njësisë frazeologjike vjen si rrjedhojë e shndërrimit semantik tërësor të strukturës dhe jo të

---

<sup>1</sup> J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe* (1999) f. 13-15.

gjymtyrëve që veçohen. Ky dallim, rrjedhimisht e çon studiuesin në përcaktimin e termit **Frazeoterm**.

Frazeotermat janë *njësi shumëfjalëshe emërore me ngurosje sintaksore, të cilat emërtojnë një kuptim të ri ose rikuptimësimi i një dukurie të re, ndryshe nga kuptimi i përbërësve*.

Togfjalëshi “*dorë zonjë*”, nga kuptimi i gjymtyrëve nuk nënkupton “*dorën e një zonje*”, por në fushën e botanikës ky togfjalësh është rikuptimësuar. Ky kuptim i ri nuk është shumë e kuptimit të elementëve përbërës, por kuptimi i tij literal është “*shkurre kacavarëse me gjethe gati rrotullare, që çel lule të kuqërremtë nga jashtë e të verdha nga brënda, të cilat i ngjajnë një dore të vogël me gishtërinj të përkulur dhe kanë erë shumë të mirë; lulemustak*”. Po kështu në togfjalëshin “*eminenca gri*”, nëse do t’i referoheshim kuptimit të tij të drejtpërdrejtë, bazuar në kuptimin e gjymtyrëve, atëherë do të thoshim se kuptimi i drejtpërdrejtë është *fama gri*, por në kuptimin literal të rikuptimësuar, ai është “*agjent sekret*”.

Një trajtim i tillë i këtyre njësive e largon punimin tonë nga ato që janë quajtur “*njësi frazeologjike*”, “*përngjitje frazeologjike*”<sup>2</sup>, “*përngjitje frazale*”<sup>3</sup> (*dead line* (pikë e vdekur)) apo “*idioma të vërteta a semantike*”<sup>4</sup>. Tashmë në këtë punim në do të operojmë vetëm me termin *Frazeotermat*.

#### **Rrugët e pasurimit të leksikut me frazeoterma**

Leksiku i gjuhës shqipe është i pasur me frazeoterma të shumta të cilat përdoren në fusha të ndryshme të jetës. Ato kanë ardhur duke u shtuar në gjuhën tonë nëpërmjet disa rrugëve. Njëra prej tyre është *rruga e brendshme e pasurimit me frazeoterma*. Kjo rrugë të shpie në vetë mundësitë që ka gjuha shqipe me mjetet e saj të brendshme për t’u pasuruar. Këto mjete mund të jenë *morfologjike*, por dhe *sintaksore*.

1. Nga pikëpamja **morfologjike** frazeotermat e mirëfillta janë kryesisht të formuara me bazë emërore, ku mund të veçojmë ndërtimet:

a. Emër + emër: *Thembra e Akilit* (angl. Achilles heel), *bletë shkëmbi*, *buf kënetë*, *bisht qeni*, *burrë dheu*, *qendra e rëndesës*, *pesha atomike*, *poli i Veriut*, *poli i Jugut*, *Kuvënd lajthish*, *pjesa e luanit* (agl. lion’s share)<sup>5</sup>;

<sup>2</sup> V. Vinogradov (1986), *Lexicology and Lexicography*, f. 239.

<sup>3</sup> J. Strassler (1982), *Idioms in English: a pragmatic Analysis*. Tübingen: Guter Narrverlag, f. 15, 16.

<sup>4</sup> V. B. Makai (1972), *Phonological Theory: Evolution and Current Practice*, New York: Holt, Rinehart, and Winston, f. 25.

<sup>5</sup> P. Qesku, *Fjalor Shqip-Anglisht-Shqip* (2004), f. 404.

b. Emër + mbiemër: *bar i egër*, *dru i kalbur*, *dru i vjetër*, *bollë e vrarë*, *çelës anglez*, *dru arre*, *rrugë qorre* (ag. blind alley), *elefant i bardhë* (angl. white elephant), *shirit i zi* (angl. black belt), *green light* (dritë jeshile), *white cheque* (çek i bardhë), *Kryq i Kuq* (angl. Red Cross), *Flamur i bardhë* (angl. white flag), *arrë e fortë* (angl. hard nut), *dele e zezë* (angl. black sheep);

c. Emër + parafjalë + emër: *këpucë me qafa*, *tel me gjëmbe*, *kockë e lëkurë*;

Duke parë ndërtimin morfologjik, vëmë re se frazeotermat janë ndërtime dygjymtyrëshe dhe në formimin e tyre nuk kanë bazë foljore, por bazë emërore dhe mbiemërore. Njëkohësisht, frazeotermat nuk paraqesin bllokim apo ngurojse të kategorive morfologjike. P.sh.: në frazeotermin *çelës anglez* mund të përdoret në të dy numrat, në të dy trajtat dhe në të gjitha rasat: Mekaniku mori *çelësin anglez*; Mekaniku mori *çelësat anglezë* të varur në mur; *Çelësi anglez* që i duhej mekanikut ishte në të djathtë të tij. Pra, lidhja midis përcaktuesit dhe bazës është e pandashme dhe e bën këtë njësi të jetë si një e tërë; p.sh.: Presidenti Amerikan jeton në Shtëpinë e Bardhë. Dhe jo Presidenti Amerikan jeton në Shtëpinë ~~me të Bardhë~~ të Amerikës.

Duke u mbështetur në kriterin tjetër morfologjik, atë të prejardhjes kemi tre nëntipa të frazeotermave:

a. *Frazeoterma të plotë*, në të cilat kuptimi i ri dhe figurshmëria është i plotë. Themi se kanë figurshmëri të plotë sepse kuptimi i përfutur nga bashkimi i këtyre dy elementeve është një zhvillim i ri kuptimor, p.sh. togfjalëshi *Arusha e Madhe*, nuk ka të bëjë me një ari polar gjigant, por me yllësin e përcaktuar në fushën e astrologjisë. E kështu mund të vazhdojmë me: *Kashta e Kumtrit*, *Udha e Qumështit*, *Poli i Veriut*, *nuse e lalës*; *gjurmë mushke*, *kali i qyqes*, *Arusha e vogël* etj.

b. *Frazeoterma të pjesshme*, kur njëra nga gjymtyrët është me kuptimin e drejtpërdrejtë dhe tjetra është në kuptimin e figurshëm, p.sh.: *kali i detit* (ang. Sea horse), *fruta deti* (ang. Sea food), *natë e bardhë*, *e premtë e zezë*, *luftë e ftohtë*, *çelës anglez*, *porta hungareze*, *lule blete*, *lule dimri*, *gjel deti*, *Shtëpi e Bardhë* (angl. White House) etj. Në këto frazeoterma, vetëm njëra fjalë hyn në përbërjen e frazeotermës me kuptim joliteral i cili zhvillohet vetëm në lidhje me fjalën tjetër që përdoret me kuptim literal. Kështu fjala *e bardhë* te frazeoterma *Shtëpi e bardhë*, në kuptimin e saj joliteral, tërësisht transparent, do të ishte “një shtëpi e lyer me bojë të bardhë, ose ku gjithçka është e bardhë”, ndërsa në kuptimin e

saj literal është: “rezidenca e presidentit të Amerikës”, dhe zhvillohet vetëm në lidhje me fjalën shtëpi, d.m.th. realizohet me përbërje semantike.

c. *Frazeoterma transparente me kuptim cilësisht të ri*. E veçanta e këtyre frazeotermave është se jo vetëm përbërësit përdoren në kuptimet e tyre literale, por edhe sepse zhvillojnë një kuptim të shtuar, për rrjedhojë, këto frazeoterma kanë një kuptim të ri. Kështu, kemi frazeotermin *dritë jeshile*, ku mbiemri *jeshile* nuk është thjesht përcaktues i emrit, por së bashku formojnë kuptimin e ri “*dritë semafori, rrugë e lirë për të kaluar; shans për të vepruar*”. E mund të vazhdonim me: *gur i qoshes, arrë e fortë, kockë e fortë, dorë e hekurt, dritë jeshile, tru i vogël, zorrë e hollë, flamur i bardhë, dërrasë e zezë, Kryqi i Kuq (angl. Red Cross), shirit i zi (angl. black belt)*. Kështu, *shirit i zi*, nuk ka të bëjë vetëm me faktin e përgjithshëm “*një shirit i zi i zakonshëm*”, por kuptimi i ri i tij është “*shkalla e matjes së njohurive dhe niveleve në artet marcialle*”

#### **Rruga e pasurimit sintaksor**

Fjalët kanë vetinë të lidhen me njëra tjetrën dhe sipas rregullave të gramatikës dhe ligjeve të gjuhës formojnë së bashku njësi gjuhësore më të larta, togfjalësha e fjali. Një pjesë e tyre krijohen në çastin kur ne flasim, ose kur shkruajmë, ndërtohen edhe me lidhje të lira aty për aty, gjatë ligjërimit, prandaj edhe quhen togfjalësha të lirë<sup>6</sup>. Në gjuhën shqipe kemi togfjalësha të lirë dhe togfjalësha të qëndrueshëm. Në përbërjen sintaksore, frazeotermat hyjnë tek grupi i togfjalëshave të qëndrueshëm sepse kanë qëndrueshmëri të elementëve përbërës dhe fitojnë një kuptim cilësisht të ri, i ndryshëm nga kuptimi literal i përbërësve. Tek frazeotermat gjejmë të pranishme kriterin e kufizimit sintaksor dhe njëkohësisht ajo përfshin njësi shumëfjalëshe terminologjike të cilat shenjojnë, përcaktojnë apo emërtojnë një vlerë, si p.sh.: *pesha atomike, qendra e rëndesës, sy magjik, nyjë Gordiane, zorrë e hollë, tru i vogël* etj. Por sikundër mund ta shikojmë me kujdes, në fjalët e mësipërme jo të gjitha e përmbajnë kuptimin e figurshëm, në rastin tonë *zorrë e hollë* apo *tru i vogël*.

Po ndërsa togfjalëshat e lirë formohen në çastin e ligjërimit, togfjalëshat e qëndrueshëm nuk formohen në çastin e ligjërimit, por janë ndërtuar historikisht dhe janë bërë të pazbërthyeshëm. Ata përdoren si njësi të gatshme, njësoj si fjalët. Si p.sh.: *ëndrra në diell, mësallë me dy faqe, me lakra në kokë, i hurit e i litarit, për bishtin e dhelprës*, etj.

<sup>6</sup>J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, f. 199, 200.

Togfjalësia të tillë janë të shumtë në gjuhën shqipe dhe përbëjnë një fond të pasur të frazeologjisë së gjuhës shqipe<sup>7</sup>

Edhe frazeotermat hyjnë tek togfjalëshat e qëndrueshëm, sepse janë njësi të gatshme, të pazbërthyeshme, dhe nuk formohen gjatë ligjërimit apo shkrimit, p.sh.: *red tape*, *black belt*, *çelës anglez*, *avaz i Mukës*, *kashta e Kumtrit* etj.

Një rrugë tjetër pasurimi me frazeoterma i gjuhës shqipe është dhe formimi i *akronimeve*. Frazeoterma të tilla në gjuhën shqipe janë në rritje të vazhdueshme, mes tjerash edhe si rrjedhojë e globalizimit. Akronimia si dukuri shumë e shpeshtë në gjuhën shqipe, si në gjuhën e folur edhe në gjuhën e shkruar, nuk është një proces risimtar, sepse paraqitja e saj kushtëzohet nga rrethanat shoqërore e politike dhe kulturore të periudhës së caktuar historike. Prodhimtaria e tyre daton rreth viteve nëntëdhjetë të shek të kaluar si pasojë e hapjes së Shqipërisë ndaj botës së gjerë, ndërtimit të realitetit të ri shoqëror e politik. Themi se edhe akronimet futen tek frazeotermat, sepse emërtojnë një dukuri, p.sh.: *SHBA (The USA)*, *Mbretëria e Bashkuar (ang. The UK)*, *Kombet e Bashkuara (ang. The United Nations)*, *BE* etj.

#### **Dallimet midis frazeotermave dhe emërtimeve të pathjeshta**

Dallimi midis frazeotermave dhe emërtimeve të pathjeshta apo njërive frazeologjike me vlerë emërore nuk është e thjeshtë, sepse kufiri ndarës i tyre është shumë i vështirë për t'u vendosur. Duke u bazuar në veprën e J. Thomait<sup>8</sup>, emërtimet e pathjeshta mund të jenë me kuptim të drejtë e të motivueshëm qartë, p.sh.: *tru i vogël*, *Poli i Veriut*, *qendra e rëndësës*, *pesha atomike*, *forca e gravitetit*, ku vëmë re se si realizohen aftësitë kombinuere të pakufizuara të elementëve përbërës të tyre, ndërsa të paktën në një përbërës të këtyre frazeotermave këto njësi janë të kufizuara, pra e thënë më saktë, një element i frazeotermave realizon kuptimin e vet të mbartur brenda një ose pak frazeotermave dhe nuk mund të përdoret me këtë kuptim në lidhje me fjalë të tjera jashtë këtij frazeotermi, si p.sh.: *çelës anglez*, apo e gjithë struktura e mbartur si p.sh.: *tru i vogël* etj.

Atëherë mund të themi se kemi tre kategori të emërtimeve të pathjeshta me vlerë emërore të qëndrueshme:

- Togfjalësia të qëndrueshëm të gjuhëve të veçanta, të specializuar, të cilët do t'i quajmë edhe njësi terminologjike, sepse iu përkasin termave të caktuara të një gjuhe, p.sh.: *çelës anglez*, *zorë e hollë* etj.

---

<sup>7</sup> J. Thomai (vep e cit).

<sup>8</sup> J. Thomai, *Fjalori frazeologjik i gjuhës shqipe*, f. 16.

- Togfjalësia të qëndrueshëm të gjuhëve të nomenklaturës, të cilat emërtojnë objekte të ndryshme, si p.sh: *Teatri i Kukullave, Muzeu Kombëtar, Fuqitë e Mëdha, Deti i Kuq, Poli i Veriut, Poli i Jugut, Shtëpia e Bardhë, etj.*

- Togfjalësia të qëndrueshëm të gjuhës së përgjithshme, si p.sh.: *nata e bardhë, sy magjik, tel me gjemba (ang. barbed wire) etj.*

Të gjithë këta togfjalësia, kanë në bërthamën e tyre bazë emërore. Por në varësi të qëndrueshmërisë së tyre, do të quajmë frazeotermat ato emërtime të pathjeshta emërore të cilat janë të qëndrueshme. Për njësitë e tjera të pathjeshta emërore, por që nuk janë togfjalësh të qëndrueshëm, do t'i quajmë të lira sepse emërtojnë kuptime transparente dhe si të tilla elementët e tyre mund të krijojnë edhe lidhje të ndryshme të tjera të pakufizuara.

*Por si mund ta dallojmë kur ato janë të qëndrueshme ose jo?*

Atëherë do të na duhet të mbështetemi në kriterin e ngurosjes leksikore dhe kuptimore të strukturës. Kur një frazeoterm është i ngurosur semantikisht dhe leksikalisht atëherë ai përbën një kuptim joliteral i cili nëse do të përdorej jashtë kësaj kornize do të humbiste kuptimin e tij, pra nuk mund të përdoret me fjalë të tjera sepse do të ndryshonte edhe kuptimi. Dallimet midis emërtimeve të pathjeshta dhe frazeotermave janë:

-Emërtimet e pathjeshta krijohen në momentin e ligjërimit ndërsa frazeotermat janë njësi të ngulitura në mënyrë të përhershme<sup>9</sup>. Frazeotermat janë njësi të ngurosura, të qëndrueshme të cilat hyjnë në ligjërime si njësi të gatshme, si p.sh.: *Udha e Qumështit, Kashta e Kumtrit, Fuqitë e Mëdha etj.*

- Frazeotermat janë “njësi të mëvetësishme leksiko-sintaksore”<sup>10</sup>, duhet të zënë vend më vete e të studiohen mundësisht si zë më vete. Frazeotermat janë të barasvlershme me fjalën dhe shërbejnë për të shënuar një objekt ose dukuri të vetme, ashtu sikundër edhe fjala vetë.

- Në emërtimet e pathjeshta kuptimi vjen si një vlerë a shumë e thjeshtë e mbledhur bashkë nga kuptimet e elementëve përbërës, ndërsa tek frazeotermat kuptimi mund të jetë kompozicional, por jo si shumë e kuptimeve të elementit përbërës, pra ato kanë opacitet semantik, p.sh: *Kashta e Kumtrit; gjurmë mushke* (bot. bimë që e ka formën e gjurmës së mushkës), *ballë kazani* (rakia e parë), këto emërtime të pathjeshta janë rikuptimësuar plotësisht në gjymtyrët e tyre, “këto emërtime të pathjeshta

---

<sup>9</sup>A. Duro, *Terminologjia si sistem* (2001), Panteon, Tiranë, f. 44.

<sup>10</sup>A. Duro, *Terminologjia si sistem* (2001), Panteon, Tiranë, f. 45-46.

Ç'janë frazeotermat, rrugët e pasurimit dhe dallimet nga emërtimet...

---

(frazeoterma në rastin tonë) kanë pësuar një rikuptimësim të plotë të gjymtyrëve veças”<sup>11</sup>.

Përveç dallimeve, frazeotermat dhe emërtimet e pathjeshta kanë edhe karakteristika të përbashkëta. Disa prej tyre janë:

- Frazeotermat dhe emërtimet e pathjeshta janë togfjalësia, sepse përbëhen nga dy ose më shumë fjalë dhe kanë lidhje gramatikore të njëjta me emërtimet e pathjeshta (përcaktuese, objektore, rrethanore etj.).

- Frazeotermat lidhen me emërtimet e pathjeshta nga prejardhja. Përgjithësisht frazeotermat e kanë burimin nga emërtimet e pathjeshta, dalin nga shndërrimi i figurshëm i tyre.

Në punime të tjera do të përpiqemi të vërejmë edhe karakteristika dalluese midis tyre, të cilat janë më të shumta dhe janë pikërisht këto dallime të cilat na bëjnë që këto njësi gjuhësore t'i veçojmë nga njëra-tjetra dukshëm. Për këtë arsye ato studiohen edhe sot në botë në mënyrë të ndarë.

---

<sup>11</sup> J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, f. 18.

